

VENDIM
Nr. 32, datë 17.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 29 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: Eranda Hidri, përfaqësuar nga avokat Arlind Ahmetaj, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1205, datë 8.4.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes civile me nr. 11243-00542-00-2021, me datë regjistrimi 10.5.2021, pranë Gjykatës së Lartë.

Detyrimi i Gjykatës së Lartë që të gjykojë çështjen brenda një afati kohor të caktuar, sa më të afërt.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases Eranda Hidri (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë e punësuar në pozicionin e financieres pranë shoqërisë “Protec Shoes” sh.p.k. (*shoqëria*), sipas kontratës së punës me afat të përcaktuar deri në datën 2.7.2013. Për periudhën 21.1.2013–16.12.2013, kërkuesja ka përfutur të ardhura për barrë lindje. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, me shkresën e datës 2.5.2013, administratori i shoqërisë e ka njoftuar kërkuesen se kontrata e punës nuk do të rinovohej më.

2. Në datën 19.5.2014, me pretendimin se largimi nga puna është bërë në kohë të papërshtatshme, gjatë kohës që ka qenë me raport për barrë lindje, dhe për arsye diskriminuuese, kërkesja i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit. Ky i fundit, me vendimin nr. 146, datë 24.9.2014, ka konstatuar diskriminimin për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë, duke i rekomanduar shoqërisë njohjen e punonjësve me ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe afishimin e tij në mjediset e shoqërisë. Në vijim, kërkesja ka vënë në lëvizje dy procese gjyqësore.

i) Procesi gjyqësor për largimin nga puna

3. Në vijim, kërkesja i është drejtuar gjykatës me padi, duke paditur shoqërinë për largimin e padrejtë nga puna. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 306, datë 21.7.2014, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar shoqërinë t’i paguajë kërkuessës 5 paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës, 2 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës dhe 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës. Ndaj këtij vendimi gjyqësor palët ndërgjyqëse nuk kanë paraqitur ankim brenda afateve ligjore, duke marrë vendimi formë të prerë.

4. Shoqëria punëdhënëse e paditur, me pretendimet se administratori i saj nuk dinte gjuhën shqipe, se nuk ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit dhe se avokati i zgjedhur nuk ia ka bërë të qartë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 35, datë 30.3.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Pas ankimit të shoqërisë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 233, datë 30.3.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar kërkesën e shoqërisë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Për rekursin e kërkuessës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1045, datë 19.3.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi ka mbetur pa objekt në kushtet kur, mbi ankimin e shoqërisë punëdhënëse të paditur, çështja e themelit ishte gjykuar në shkallë të dytë, në përfundim të të cilit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 352, datë 25.11.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 306, datë 21.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe rrëzimin e padisë së kërkuessës.

ii) Procesi gjyqësor për mbrojtjen nga diskriminimi

5. Në datën 17.1.2017, kërkesja i është drejtuar gjykatës me padi për konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin e shoqërisë punëdhënëse për ta dëmshpërblyer atë dhe familjarët e saj K. H. dhe A. H. për dëmin jopasuror. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 152, datë 10.4.2018, ka vendosur pranimin e padisë, konstatimin e diskriminimit të kërkuessës nga punëdhënësi dhe detyrimin e tij për ta dëmshpërblyer atë dhe familjarët e saj për dëmin jopasuror të pësuar në vlerën totale 6.046.326 lekë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim shoqëria e paditur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 352, datë 25.11.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuessës. Kundër këtij vendimi kërkesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja është regjistruar me nr. 11243-00542-00-2021, datë 10.5.2021.

6. Kërkesja, në datat 28.4.2023, 15.1.2024 dhe 7.2.2024, i është drejtuar me kërkesë gjyqtarit relator për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, por çështja nuk është planifikuar për gjykim. Në datën 26.2.2025, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë tashmë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin nga ajo të procedurës së gjykimit të çështjes. Për këtë kërkesë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1205, datë 8.4.2025, ka vendosur rrëzimin e saj, duke arsyetuar në mënyrë të përmblodhur se mosveprimi i Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësimin dhe qëndrimin abuziv të

gjyqtarit relator, por për shkak të pamundësisë objektive të asaj gjykate si rezultat i ngarkesës së madhe nga akumulimi ndër vite i dosjeve, një problematikë e përgjithshme kjo që tejkalon rastin konkret dhe që është shkaktuar nga reforma në drejtësi, e cila ka sjellë natyrshëm edhe kosto për qytetarët në formën e tejzgjatjes së afateve të gjykimit të çështjeve gjyqësore.

7. Në datën 22.9.2025 (*data e shërbimit postar*) kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa është regjistruar në datën 3.10.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 3.12.2025, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatet ligjore, duke zvarritur në mënyrë të paarsyeshme shqyrtimin e çështjes prej më shumë se katër vjetësh, ndërsa numri i lartë i çështjeve për shqyrtim në atë gjykatë nuk mund të justifikojë vonesën, duke iu referuar për këtë edhe jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Kjo vonesë nuk është shkaktuar nga kërkesja, e cila, përkundrazi, është interesuar në mënyrë të vazhdueshme, duke paraqitur, në vitet 2023 dhe 2024, tri kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjyqtari relator. Çështja, sikurse edhe vetë Gjykata e Lartë është shprehur, nuk paraqitet komplekse, ndërkohë që nga tejzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore interesi i kërkuarës rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë që çështja në themel ka të bëjë me rivendosjen e të drejtave të cenuara në marrëdhënien e punësimit për shkak të diskriminimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Po kështu, kërkesja ka *shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion*, pasi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin

e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga ajo gjykatë, ndaj i vetmi mjet në dispozicion është ankimi kushtetues individual.

12. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, ndonëse mban datën 8.4.2025, nuk i është komunikuar kërkueses dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate vetëm në datën 22.5.2025, ndërkohë që kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 22.9.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e cila, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatet ligjore, duke zvarritur në mënyrë të paarsyeshme shqyrtimin e çështjes prej më shumë se katër vjetësh, ndërsa numri i lartë i çështjeve për shqyrtim në atë gjykatë nuk mund të justifikojë vonesën, duke iu referuar për këtë edhe jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së. Kjo vonesë, sipas kërkueses, nuk është shkaktuar nga ajo, ndërsa është interesuar në mënyrë të vazhdueshme duke paraqitur, në vitet 2023 dhe 2024, tri kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjyqtari relator. Çështja, vijon kërkuesja, sikurse edhe vetë Gjykata e Lartë është shprehur, nuk paraqitet komplekse, ndërkohë që nga tejzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore interesi i saj rrezikohet në shkallë të konsiderueshme për sa kohë që çështja në themel ka të bëjë me rivendosjen e të drejtave të cenuara në marrëdhënien e punësimit për shkak të diskriminimit.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset tek palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, procesi gjyqësor është vënë në lëvizje me padi të paraqitur nga kërkuesja në datën 17.1.2017, për konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë dhe detyrimin e punëdhënësit për ta dëmshpërblyer atë dhe familjarët e saj për dëmin jopasuror të shkaktuar si pasojë e largimit të padrejtë nga puna. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 10.4.2018, ka vendosur pranimin e padisë, konstatimin e diskriminimit të kërkueses nga punëdhënësi dhe detyrimin e tij për ta dëmshpërblyer atë dhe familjarët e saj për dëmin jopasuror të pësuar. Pas ankimit të shoqërisë punëdhënëse të paditur, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 25.11.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkueses. Kjo e fundit ka ushtruar rekurs dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.5.2021. Pas më shumë se 3 vjetësh e 9 muajsh nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, ndonëse kërkuesja ka kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 8.4.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Aktualisht, deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, ka kaluar një kohë prej 9 vjetësh e 2 muajsh, ndërsa vetëm në Gjykatën e Lartë çështja ka mbetur në pritje për t’u shqyrtuar përreth 4 vjet e 10 muaj.

17. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin ligjor 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së). Nisur nga kjo, formalisht, gjykimi i çështjes së kërkuës në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

18. Për pasojë, është rasti që ky tejkalim i afatit të gjykimit të çështjes të vlerësohet në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për tejzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit, të cilat konsistojnë në: i. sjelljen e kërkuës; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuës, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë që të justifikojë një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuësja*, në rastin konkret, për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së saj.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” duhet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuës verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në konsideratë të kësaj jurisprudence, Gjykata vëren se mosmarrëveshja në shqyrtim përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm lidhet ngushtësisht me mbrojtjen nga diskriminimi në kuadër të marrëdhënies së punës, në kushtet kur kërkuësja pretendon se është cenuar për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë dhe kërkon, si pasojë, dëmshpërblim për dëm jopasuror. Edhe pse vlerësimi nëse një çështje prek interesa “vetjakë e jetësorë” bëhet rast pas rasti, natyra e kësaj mosmarrëveshjeje, e lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe me mbrojtjen nga diskriminimi, justifikon trajtimin e saj me kujdes të shtuar. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në kontekst të rrethanave konkrete, vonesa në gjykim prek një interes të rëndësishëm të kërkuës, çka justifikon trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata e Lartë.

22. Për më tepër, referuar qëndrimit të GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Gjithashtu, ajo ka theksuar se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak. Faktorë të tillë, të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të aftë, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih vendimin nr. 54, datë 9.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor tashmë vijon prej më shumë se 9 vjetësh e 2 muajsh, ndërsa vetëm në Gjykatën e Lartë çështja është në pritje për t'u shqyrtuar prej 4 vjetësh e 10 muajsh, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuësës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vendimi nr. 00-2025-1205, datë 8.4.2025, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuësës *duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata e Lartë*.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuësës duhet të pranohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1205, datë 8.4.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-00542-00-2021, datë 10.5.2021, në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.3.2026.

Shpallur më 16.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska, Asim Vokshi